

KOMBFORMIMI SIMBOLIK NË EVROPËN JUGLINDORE



redaktore

VJOLLCA KRASNIQI

KOMBFORMIMI SIMBOLIK
NË EVROPËN JUGLINDORE

redaktore

VJOLLCA KRASNIQI

Titulli i librit: Kombformimi simbolik në Evropën Juglindore
Redaktore: Vjollca Krasniqi
Titulli i originalit në gjuhën angleze:
*Strategies of Symbolic Nation-building in South
Eastern Europe*, redaktor Pål Kostø, Farnham, Surrey,
Britani e Madhe: Ashgate Publishing (2014).

Përkthimi: Translation Center
Lektura: Fadil Grajçevci
Redaktura teknike: Teuta Osmani
Foto në ballinë: Rita Rose & Visar Dyla
Botues: Qendra për Hulumtime dhe Politikë Gjinore,
Shtator 2013, Prishtinë, Kosovë
Design and rradhitja: Rrota, Prishtinë, Kosovë
Shtypi: Raster, Prishtinë, Kosovë
ISBN: 978-9951-400-01-5



NORWEGIAN EMBASSY

Ky publikim është mbështetur nga Ambasada Norvegjeze në Kosovë.
Opinionet e shprehura këtu janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë
qëndrimet e Qeverisë Norvegjeze.

Përmbajtja

Parathënia e redaktores <i>Vjollca Krasniqi</i>	9
Parathënie e redaktorit të librit në gjuhën angleze <i>Pål Kolstø</i>	12
Hyrje <i>Pål Kolstø</i>	14
Përmbushja e ëndrrës mijëvjeçare: <i>Strategjitë e kombformimit simbolik në Kroaci Vjerran Pavlaković</i>	45
Nofullat e kombit dhe përfaqimet e dobëta të shtetit: <i>Vijat e ndarjes, të mospërfilljes dhe të besnikërisë në Bosnje e Hercegovinë Ana Dević</i>	91
Serbia dhe (ri) formimi simbolik i kombit <i>Vladan Jovanović</i>	145
Kur dy duar e përkundin djepin : <i>Dimensionet simbolike të ndarjes rreth shtetësisë dhe identitetit në Mal të Zi Jelena Dzankić</i>	189
Kosova: <i>Topografia e ndërtimit të kombit Vjollca Krasniqi</i>	227
Strategjitë për formimin e shtetit dhe të kombit maqedonas dhe projektet kundërshtare (1991-2012) <i>Ljupčo S. Risteski dhe Armanda Kodra Hysa</i>	267
Raporti për gjendjen në Shqipëri në 100 vjet <i>Cecilie Endresen</i>	325
Përfundime Suksesi dhe dështimi i kombformimit: <i>Faktorët strukturore kundrejt atyre politike Pål Kolstø dhe Vatroslav Jelovica</i>	367
Shënime për kontribuuesit	392
Index	395

Serbia dhe (ri) formimi simbolik i kombit

VLADAN JOVANOVIĆ

Nëse e zbatojmë tipologjinë e dyfishtë të kombeve të paraqitur nga Hans Kohn, mund të themi se kombi serb, në mesin e shekullit XX, aplikoi paradigmën klasike të kombeve të stilit lindor, që bazohet në etni dhe në prejardhje. Njëra nga karakteristikat e modelit etnocentrik është ‘provincializmi i tepërt dhe *ksenofobia* e përgjakshme’, siç thotë edhe Geertz (cituar nga Subotić 2005: 57). Për më tepër, ka mungesë të kombinimeve të ndryshme në etnohistorinë e Serbisë; kjo e ka bërë më të lehtë punën e intelektualëve, të cilët propagandën nacionaliste e shfrytëzuan për të manipuluar dhe nxitur vetëdijen kombëtare (Bakić 2006: 243). Natyrisht, përdorimi (dhe keqpërdorimi) i mitit dhe i historisë nuk kufizohet vetëm brenda Ballkanit (për më shumë shiko Kolstø 2005: 1–2). Megjithatë, nëse e shohim nacionalizmin si ‘parim politik, sipas të cilit njëzia politike e kombëtare janë në harmoni’ (Gellner 1997: 11; shiko po ashtu Bakić 2006: 250), atëherë Serbia e sotme mund të konsiderohet si ‘përdoruese’ e këtij fenomeni.

Për të qenë në gjendje që ta analizojmë fazën aktuale të procesit të kombformimit serb, duhet të kthehemi të paktën dy dekada prapa në histori. Serbia, në vitet 1990, mund të karakterizohet si hibrid i një shteti autoritar dhe gjysmë-demokratik: pas socializmit dhe nacionalizmit. Duke pasur parasysh minimumin veprues të parimeve demokratike që ekzistuan për të maskuar natyrën e vërtetë autoritare të regjimit të kohës, ajo ishte ‘një gjysmë-demokraci etnike’ (Bieber 2005: 167). Kur Zoran Đinđić-i, më 1991, shtroi